

**PROGRAMI I TRANSPARENCËS
PËR
GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË**

HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Pergjithshëm Korçë. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”(LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Pergjithshëm Korçë ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Pergjithshëm Korçë do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit e Pergjithshëm Korçë, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare <http://www.gjykata.gov.al/rrethi-korcë/gjykata-e-shkallës-së-parë-e-juridiksionit-të-pergjithshëm-korcë/> si dhe në mjediset e pritjes së publikut.

Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Pergjithshëm Korçë është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj. Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Pergjithshëm Korçë janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.

2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Pergjithshëm Korçë ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e AP-së dhe përkatësisht: Ligji nr Nr.98/2016, “PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.
4. ”Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Pergjithshëm Korçë vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit <http://www.gjykata.gov.al/rrethi-korcë/gjykata-e-shkallës-së-parë-e-juridiksionit-të-pergjithshëm-korcë/> dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;
- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim

të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Pergjithshëm Korçë, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Pergjithshëm Korçë, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Pergjithshëm Korçë.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR KORÇË

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	Organigrama e Gjykatës. Struktura organizative e miratuar. Struktura e pagave. Tabelë e funksioneve dhe e detyrave. CV-të e funksionarëve të lartë. Rregullore e brendshme Kodi i etikës Ligji Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; Ligji Nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; Ligji Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” Akte ligjore/nënligjore	Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare. Menjëherë pas hyrjes në fuqi. Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari.	Rubrika “Programi i transparencës”.	KLGJ Kryetari i Gjykatës Këshilli i Gjykatës Koordinatori
Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b	Ligje Akte nën ligjore Rregullore	Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare. Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari.	Rubrika “Rregullore të Gjykatës”	KLGJ Kryetari i Gjykatës Koordinatori

Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g	Format kerkese per Informacion. Format ankese.	Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari.	Rubrika “Programi i transparencës”	Koordinatori
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Neni 7/1/ç	Adrese kontakti: Lagjia Nr.3, Rr. "Nene Tereza", Korce. E hene-E preme 08.00.16.00 Koordinatori: Emis Grabocka E-mail: emis.grabocka@gjyka.ta.gov.al	Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari.	Rubrika “Rreth Gjykatës” Rubrika “Rrjeti Publik i Email-eve Zyrtare”	Koordinatori
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d	Ligj Nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë; Ligji Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.	Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare. Menjëherë pas hyrjes në fuqi.	Rubrika “Programi i transparencës”	Koordinatori
Mekanizmat monitorues; raporte auditiv; dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh	Ligji Nr 114/2015 date 22.10.2015 “Per auditimin e brendshem ne sektorin publik. Ligji Nr 10296 date 08.07.2010 “Per menaxhimin financiar	Përditësim periodik	Rubrika “Programi i transparencës”	Zyra e Buxhetit

		dhe kontrollin i ndryshuar me ligjin Nr 110/2015			
Buxheti	Neni 7/1/e	Ligji për buxhetin dhe akte nënligjore në zbatim të tij Udhëzim Nr. 7/1 , Datë 28.02.2014 "Për Përgatitjen e Buxhetit Vendor" Udhëzim Nr. 2 Datë 06.02.2012 “Për Proçedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”	Menjëherë pas hyrjes në fuqi.	Rubrika “Programi i transparencës”	Zyra e Buxhetit
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë	VKM Nr.914 datë29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit publik”, Udhëzimi Nr.2, datë 27.01.2015“Për hartimin e regjistrit të prokurimit publik” Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”(i ndryshuar)	Menjëherë pas dërgimit në Agjencinë së Prokurimit Publik.	Rubrika “Programi i Transparencës”. Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik: www.app.gov.al	Zyra e Buxhetit
Shërbimet e autoritetit për publikun.	Neni 7/1/f	Udhëzimi i përbashkët Nr.33,datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrise së Drejtësisë,Shërbimit Përmbarimor, Noterisë	Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare.	Rubrika “Mbi Gjykatën”	Kancelarja e Gjykatës
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Neni 7/1/gj	Projekt - akte ligjore dhe nënligjore.	Pas miratimit të ligjit apo të projektit.	Rubrika “ Publikime”	KLJGJ

Mbajtja e dokumentacionit nga AP	Neni 7/1/h	Ligji. nr.9154, datë 06.11.2003. “Për arkivat”.VKM nr. 903, Datë 17.12.2014 “Për krijimin e arkivit shtetëror të sistemit gjyqësor”	Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare.	Rubrika “Publikime”	Arkiva
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014.	Neni 7/1/i	Tabele ne format elektronik	Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari.	Rubrika “Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve”	Koordinatori
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	Shpallje vendime gjyqësore, informacion mbi shortin, date te gjykimeve etj	Menjëherë	Rubrika “Informacion Mbi Shortin”. Rubrika “Ceshtje gjyqësore” Rubrika “Kalendari i seancave”	Koordinatori
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l	Njoftime me afishim publik Njoftime	Menjëherë	Rubrika “Shpallje publike”	Koordinatori

PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Pergjithshëm Korçë vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit <http://www.gjykata.gov.al/rrethi-korcë/gjykata-e-shkallës-së-parë-e-juridiksionit-të-pergjithshëm-korcë/> dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit. Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.